

Konsultim publik mbi projektligjin

“Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë”,

organizuar në Shkodër, në ambientet e Qendrës së Informacionit të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të projektit “Zbatimi dhe forcimi i nismave ligjvënëse qytetare të parashikuara në Kushtetutë, përmes përmirësimeve ligjore dhe rritjes së aktivizmit të shoqërisë civile”, të mbështetur dhe financuar nga Fondacioni “Soros”, më 17 Nëntor, 2016, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare organizoi tryezën e rrumbullakët me temë: “Konsultim publik mbi projektligjin 'Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë’”.

Në tryezë morën pjesë 48 pjesëmarrës, pedagogë dhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Prof.As.Dr. Entela Baci (Hoxhaj), dhe Dr. Valbona PAJO, eksperte ligjore, prezantuan për pjesëmarrësit projektligjin 'Për Nismën Ligjvënëse Popullore në RSH'.

Pjesëmarrësit vlerësuan këtë iniciativë dhe morën pjesë në diskutime mbi nevojën e krijimit të kuadrit të përshtatshëm ligjor për ndërmarrjen dhe ushtrimin e nismave ligjvënëse qytetare. Ata operaqitwn sugjerime të vlefshme për përmirësimin e dispozitave të projektit që lidhen me procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, të drejtën e ankimit në rastin e një vendimi refuzues, krijimin dhe organizimin e Komitetit Përfaqësues të nismës, rolin e shoqërisë civile dhe qytetarëve në këtë iniciativë, institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e ligjit, vlerësimin e projektligjit në pajtim me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, etj.

Aktiviteti u bë publik në Televizionet “Rozafa”, Antena Televizion, STAR dhe A1 Televizion në Shkodër, ndërsa cilat Znj. Entela Baci (Hoxhaj) prezantoi rëndësinë e projektligjit dhe kontributin e pedagogëve dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në përmirësimin e tij.

Konkluzionet e tryezës do të kontribuojnë në përmirësimin e përmbajtjes së projektligjit.





Foto nga tryeza